

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazie. Date / Dina <u>17 / 12 / 2020</u>		
Nr. Orgv. Org. jed. <u>01</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>198/20</u>	Nr. Fajeve. Br. Strana. <u>3</u>
Ferizaj - Ilroševac		

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 191-1/20 Data 17.12.2020
PRISHTINË



**KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI**
Prishtinë

**Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave,
Ferizaj**

**Kolegji BIZNESI,
Prishtinë**

MEMORANDUM BASHKPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme :

Kolegji BIZNESI, që është institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, i Akredituar nga "Agjencia Kosovare e Akreditimit", dhe i licensuar nga "Ministria e Shkencës dhe e Teknologjisë", që ka si objektive të sigurojë veprimtari arsimore dhe shkencore, kultivimin e dijes dhe shkencës, mbështetjen e shoqërisë në aspektin ekonomik dhe social, si dhe afrimin e vlerave kombëtare dhe evropiane .

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Ferizaj, institucion në komunën e Ferizajit.

Palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandum Bashkpunimi si më poshtë :

Neni 1

Qëllimi

- Ofrimi i mundësisë së studentëve të Kolegjit BIZNESI, programi "Menaxhimi i emergjencave , Teknik i Mbrojtjes nga Zjarri", në realizimin e pjesës praktike në këtë institucion.
- Shfrytëzimin e paisjeve dhe poligonit praktik të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Ferizaj.

- Bashkëpunimi me zjarrfikësit profesional për realizimi e pjesës praktike të programeve trajnuese të Kolegjit BIZNESI.

Neni 2

Objekti

- Të dyja institucionet deklarojnë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi me qëllim të aftësimit të studentëve.

Neni 3

Komunikimi

- Palët do të caktojnë persona kontakti që do jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në raste e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Ndryshime

- Memorandum mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndersjelltë me shkrim të palëve.

Neni 5

Afati i Memorandumit të Bashkpunimit

- Memorandumi lidhet me një afat pesë (5) vjeçar duke filluar 14.12.2020 deri me 14.12.2025.

- Memorandumi mund të vazhdohet me vullnetin e palëve për një afat tjetër të përcaktuar.
- Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga pala tjetër.
- Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa sa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

- Ky Memorandum Bashkupnimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgaditet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave në Komunen e Ferizajt dhe dy të tjera në Kolegjin "BIZNESI".
- Ky Memorandum Bashkupnimi u nënshkrua sot me datë 14 Dhjetor 2020.

Për: KOLEGJI BIZNESI

Prof.Dr.Shyqeri KABASHI

Dekani




Për: KOMUNËN E FERIZAJT

Arben Halili

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave




Ferizaj 14 Dhjetor 2020